

VENDIM
Nr. 222, datë 20.12.2019

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SHPK,
NR. 262, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-s NR. 7, DATË 2.2.2015**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 119/9 prot., datë 18.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 32/56, datë 26.11.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k..

- Me shkresën nr. 727/1 prot., datë 3.12.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 727/1 prot., datë 13.12.2019, shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 27.9.2014 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUI) L42203031A.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 262, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015, me afat 5-vjeçar.

- Referuar sa më sipër, konstatohet se shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., ka aplikuar brenda afatit ligjor për rinovimin e licencës.

Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat: “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., me nr. 262, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015 për një afat 5-vjeçar, duke filluar vlefshmërinë e saj nga data 3.2.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti